



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes propozon:

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e dates 4 qershor 2008, Ligjit për Zonat Ekonomike , nenit 10 të Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr.03/2014 për procedurën, formën dhe përmbajtjen e konkursit, kushtet dhe kriteret për vendosjen e subjekteve afariste brenda hapësirave të zonave ekonomike, nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës _____ 2022, të miratojë këtë :

PROPOZIM

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR SHQYRTIMIN E
DOKUMENTACIONIT PËR VENDOSJEN E BIZNESEVE NË ZONËN EKONOMIKE
"PARKU INDUSTRIAL" NË QYLAGË -FAZA E PARË

Neni 1

Përbërja e Komisionit

Formohet Komisioni vlerësues për shqyrtimin e dokumentacionit të pranuar nga bizneset afariste të cilat do të aplikojnë sipas konkursit publik për t'u vendosur në Zonën Ekonomike "Parku Industrial " në Qylagë – faza e parë (në vazhdim të tekstit: Komisioni në përbërje prej 5 (pesë) anëtarëve:

1. _____ nga ekzekutivi i komunës, kryesues
2. _____ nga ekzekutivi i komunës, anëtar
3. _____ nga kuvendi i komunës, anëtar
4. _____ nga kuvendi i komunës, anëtar
5. _____ nga shoqëria civile , anëtar

Neni 2

Mandati i anëtarëve

Mandati i anëtarëve të Komisionit është i përkohshëm vetëm për konkursin publik për vendosjen e bizneseve në zonën ekonomike "Parku Industrial" në ZK Qylagë- faza e parë dhe brenda mandatit të Kuvendit të Komunës.

Neni 3

Detyrat dhe Përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni ka për detyrë dhe përgjegjësi të bëj shqyrtimin e dokumentacionit të pranuar nga bizneset afariste të cilat do të aplikojnë sipas konkursit publik për t'u vendosur në Zonën Ekonomike "Parku Industrial " në Qylagë, konform procedurave dhe kritereve të përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Zonat Ekonomike dhe Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr.03/2014 për procedurën, formën dhe përmbajtjen e konkursit, kushtet dhe kriteret për vendosjen e subjekteve afariste brenda hapësirave të zonave ekonomike, kritereve të përcaktuara në konkursin publik si dhe dispozitave tjera ligjore përkatëse.

Neni 5

Punët administrative - juridike të Komisionit

Komisionit në realizimin e detyrave të përcaktuara me Ligj me akte nënligjore dhe me këtë vendim do ti ndihmojnë në kuadër të kompetencave të tyre Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim.

Neni 6

Kompenzimi i punës së Komisionit

Anëtarët e Komisionit për punën e tyre për zbatimin e procedurave të vlerësimit të ofertave të një Konkursi publik do të kompenzohen në lartësinë e një kompenzimi, i cili u paguhet për pjesëmarrje në mbledhje anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa. Kompenzimi do të bëhet vetëm për anëtarët e komisionit të cilët nuk e kanë të ndaluar kompenzimin për kryerjen e shërbimeve shtesë konform dispozitave të Ligjit për Menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe akteve tjera nënligjore me të cilat rregullohet kjo çështje nëse të njëjtat nuk bien në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës

Arsyetim

Baza juridike

Baza juridike për të propozuar Vendimin është e përcaktuar me dispozitat e nenit 58 shkronja h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 40 shkronja h.) e Statutit të Komunës së Lipjanit.

Baza juridike dhe obligimi ligjor për të miratuar këtë Vendim është e përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Zonat Ekonomike , nenit 10 të Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr.03/2014 për procedurën, formën dhe përmbajtjen e konkursit, kushtet dhe kriteret për vendosjen e subjekteve afariste brenda hapësirave të zonave ekonomike.

Komisioni ka për detyrë dhe përgjegjësi të bëj shqyrtimin e dokumentacionit të pranuar nga bizneset afariste të cilat do të aplikojnë sipas konkursit publik për t'u vendosur në Zonën Ekonomike "Parku Industrial " në Qylagë, konform procedurave dhe kriterëve të përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Zonat Ekonomike dhe Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr.03/2014 për procedurën, formën dhe përmbajtjen e konkursit, kushtet dhe kriteret për vendosjen e subjekteve afariste brenda hapësirave të zonave ekonomike, kriterëve të përcaktuara në konkursin publik si dhe dispozitave tjera ligjore përkatëse.

Nga të cekurat më lartë, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

1Nr. 011/01-25404

Lipjan, 18.05 2022

